



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
*Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme,
Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.*

Nr. 812/18Prot.

Tiranë, më 24/12/2016

V E N D I M

Nr. 157, Datë 24/12/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME LUSHNJË “PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS LIGJORE NË PRANIMIN DHE ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR PËR REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, EVIDENTIMIN DHE TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit, të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 30 dhe 32 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve” të ushtruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në një rast, ka regjistruar në ZK nr. 3325, fshati Shegas Lushnjë, në emër të trashëgimtarëve të Sh. K., pasurinë nr. 352/9, në volum 6, faqe 39, në zërin kadastral “Ullishte”, me sipërfaqe **3000 m²**, sipas dokumentacionit që ndodhet në referencën nr. 0104”, të përfituar me vendimin nr. 591, datë 12.03.2014 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, në bazë të ligjit nr. 9235, date 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” i ndryshuar. **Në lidhje me këtë vendim, u konstatua se pasuria është regjistruar në mënyrë abuzive, pasi nga verifikimi del se ky vendim nuk ekziston, pra është i falsifikuar.** Gjithashtu nuk janë verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes të vendimit nr. 591, datë 12.03.2014 dhe konkretisht:

- **së pari:** akti është paraqitur në ZVRPP Lushnjë nga qytetari dhe jo me shkresë nga ATP;
- **së dyti:** vlerësohet se nënshkrimi i vendimit nr. 591, datë 12.03.2014 dhe shkresa që njofton qytetarin nuk përmbajnë nënshkrimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ATP znj. S. Q.
- **së treti:** akti është regjistruar pa ardhur konfirmimi nga ATP Tiranë, kërkuar nga ZVRPP Lushnjë me shkresë nr. 633, datë 16.04.2014, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;
- **së katërti:** nënshkrimi në HTR që i bashkëngjitet certifikatës së pronësisë datë 21.07.2014, është i pa identifikueshëm, pasi nuk mban emrin e përpunuesit.

Në përfundim të auditimit të dokumentacionit të kësaj praktike dokumentare vlerësohet se ky vendim është regjistruar në mënyrë abuzive, mbasi akti ka ardhur dorazi në ZVRPP, firma e Drejtorit të Përgjithshëm të ATP Pronave Tiranë është e ndryshme nga praktikat e tjera shkreore. Kjo praktike është përpunuar nga ish-juristi S. K. dhe ish-Regjistruesi B. K. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 3325 për pasurinë nr. 352/9, volum 6, faqe 39, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

2. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në 11 raste, ka regjistruar një sipërfaqe bujqësore prej 124880 m², në zërin kadastral “arë”, në ZK nr. 8572 qyteti Lushnjë, e përfituar me AMTP nga komisionet e ndarjes së tokës dhe komisioni i kthimit të pronave, nga ku doli se janë regjistruar dhe pajisur me vërtetime hipotekore qytetarët, të cilët kanë kryer transaksione dhënie me qira apo shitblerje. Në lidhje me këtë fenomen kërkuesit duhej të ishin pajisur me certifikata pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Rregulloren nr. 61, datë 02.08.1999 “Për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në raste të veçanta”. Ndërkohë në këtë ZK nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar masiv (por veprohet me regjistrime sporadike).

Në lidhje me kryerjen e regjistrimit fillestar të tokave bujqësore, duhet të realizohet sipas kërkesave të Rregullores nr. 61, datë 02.08.1999 “Për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në raste të veçanta”, sipas këtij dokumentacioni ligjor, (akti i fitimit të titullit të pronësisë siç është AMTP-ja), ndërsa sipas dokumentacioni teknik, në zbatim të kërkesës së kësaj rregulloreje, që janë: plan rievimi i pasurisë “mëmë”; plan rievimi i pasurisë që regjistrohet dhe libri i ngastrës.

Për sa më sipër krijohet një dosje për çdo kërkues dhe dërgohet në ZQRPP Tiranë për të marrë miratimin për vazhdimin e mëtejshëm të veprimeve.

Mbas miratimit nga ZQRPP të praktikës dokumentare, nga Zyra vendore bëhet afishimi publik prej 45 ditë dhe nëse nuk ka kontestime, pajiset me certifikatë kërkuesi (*Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në rastet e konstatuara më sipër në ZK nr. 8572, për pasuritë e përfituara me AMTP, deri në plotësimin me

dokumentacionin tekniko ligjor në zbatim të Rregullores nr. 61, datë 02.08.1999 “Për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në raste të veçanta”.

Brenda muajt Mars 2017

3. Gjetje: Në ZVRPP Lushnjë, në **6 raste** në ZK nr. 8572, rezultuan të pa regjistruara hapësirat e përbashkëta të pallateve me **sipërfaqe 5032.34 m²**, nuk janë prerë aplikime për njësi të individualizuara (garazhe), diferenca tarife regjistrimi nga 6500 lekë në 5000 lekë, me një vlerë të pa arkëtuar **prej 5,078,215 lekë, që përbën dëm ekonomik**, ku në mënyrë analitike pasqyrohen:

* Ref. nr. 09222, për subjektin “A” ShPK, pasuria nr. 1/229, regjistruar volum 23, faqe 69, me sipërfaqe të sheshit 1520 m², sipërfaqe ndërtimi 1113 m², koeficienti i shfrytëzimit 73.2%, lartësia e përgjithshme 25 m, nr maksimal i kateve mbi tokë 8 dhe nëntokë 1, pa përcaktuar kondicionet teknike në F2, llogaritur detyrimi **gjithsej 1,515,576 lekë**, e përbërë:

- sip të përbashkëta të pa regjistruara 1693.68 m² x 700 lekë m² sipas tarifës = 1,185,576 lekë;
- diferenca prej 1500 lekë për njësi 77 njësi (nga 6500 lekë prerë 5000 lekë) = 115,500 lekë;
- pa prerë aplikime për 33 njësi të individualizuara garazhe x 6500 lekë secili = 214,500 lekë;
pasi janë regjistruar si njësi të vetme dhe të pandara në total podrum me sipërfaqe 1174 m², ndërkohë që sipas projektit rezulton të ketë 33 njësi të ndara e të individualizuara garazhe.

* Referenca nr. 08799, subjekti “T” ShPK, pasuria nr. 1/462 v 22, faqe 189 me sipërfaqe të sheshit 1573 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 1020 m², **gjithsej 1,312,011 lekë**, e përbërë:

- sipërfaqe të përbashkëta të pa regjistruara 1160.73 m² x 700 lekë m² sipas tarifës = 812,511 lekë;

- diferenca prej 3500 lekë për njësi 87 njësi (nga 6500 lekë prerë 3000 lekë) = 304,500 lekë;
- pa prerë aplikime për 30 njësi të individualizuara garazhe x 6500 lekë secili = 195,000 lekë;

* Referenca nr. 08213, subjekti “G” ShPK, pasuria nr. 1/437, për regjistrimin fillestar të pallatit, me sipërfaqe sheshi 1020 m², nga kjo ndërtesë 367 m², regjistruar në v. 20, faqe 168, sipërfaqja e përbashkët e pa regjistruar 343 x 700 lekë sipas tarifës = **240,100 lekë**.

* Referenca nr. 011536, subjekti “G” ShPK, pasuria nr. 1/540 për regjistrim fillestar të pallatit, me sipërfaqe 727 m², regjistruar në volum 24, faqe 156, sipërfaqja e përbashkët e pa regjistruar 457.33 x 700 lekë sipas tarifës = 320,131 lekë.

- diferenca midis situacionit përfundimtar dhe preventivit është 24.235.214 lekë e barabartë me 727,056 lekë të ardhura të munguara për bashkinë Lushnjë, **në total 1,047,187 lekë**;

- ka mos përputhje të nr. pasurisë të përshkruar në kontratën e sipërmarrjes nr. 1/300 me sipërfaqe 600 m², me lejen e sheshit që është pasuria nr. 1/540 me sipërfaqe 3286 m²;

- mungon vërtetimi i degës tatim taksave që subjekti ndërtues ka shlyer detyrimet tatimore;

* Referenca nr. 011611, subjekti “I” ShPK, pasuria nr. 8/147 volum 24, faqe 229 me sipërfaqe të sheshit 335 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 295 m², **gjithsej 182,581 lekë**, e përbërë nga, sipërfaqe të përbashkëta të pa regjistruara 260.83 m² x 700 lekë m² = 182,581 lekë;

* Referenca nr. 08232, subjekti “E”. dhe “A”, pasuria 9/239, për regjistrimin fillestar të pallatit, me sipërfaqe sheshi 1385 m², nga kjo ndërtesë 1052 m², sipërfaqja e përbashkët e pa regjistruar 1116.8 x 700 lekë sipas tarifës = **781,760 lekë**, veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me kërkesat e nenit 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe nenin 79, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe neni 42, dhe 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZVRPP dhe të procedurave për nxjerrjen e urdhrin të regjistrimit”, Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 57-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 3325 për pasuritë nr. 1/229, volum 23, faqe 69; nr. 1/462, volum 22, faqe 189, nr. 1/437, volum 20, faqe 168; nr. 1/540, volum 24, faqe 156; nr. 8/147 volum 24, faqe 229 dhe nr. 9/239, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor, deri në arkëtimin e plotë të vlerës.

Brenda muajit Mars 2017

4. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **një rast**, ka regjistruar, sipas **referencë nr. 09938** në ZK nr. 8572, në volum 24, faqe 117, në emër të B.Q. është lëshuar vërtetim pronësie nr. 1, datë 07.01.2013, për pasurinë nr. 18/17 në llojin e pasurisë truall me sipërfaqe 411 m² dhe ndërtesë 2 kat me sipërfaqe ndërtimi 137.8 m², ndodhur në lagjen “18 Tetori” Lushnjë, sipas leje legalizimi nr. 43122, datë 20.11.2012, ndërsa sipas VKM nr. 513, datë 01.08.2012, parcela ndërtimore është miratuar me sipërfaqe 411 m² dhe sipërfaqja ndërtimore 127.7 m² me lartësi 2 kate. Duke krahasuar lejen e legalizimit me VKM del se është legalizuar më tepër një sipërfaqe ndërtimore 10.10 m². Gjithashtu, nga krahasimi i genplanit të kësaj sipërfaqeje dhe hedhja në hartën e punës të zyrës, del se ka zhvendosje në hartë duke u **mbivendosur me pasurinë shtet të llojit kanal**, veprim në papajtueshmëri me nenin 28, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 101-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8572 për pasurinë nr. 18/17, volum 24, faqe 117, për zgjidhjen e mbivendosjes së krijuar, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

5. Gjetje: Në ZVRPP Lushnjë, në **9 raste** në ZK nr. 8572 qytet Lushnjë, në lidhje me pranimin e dokumentacionit sipas vendimeve gjyqësore, kalimi nga hipoteka në sistem dhe regjistrimi i tyre dolën mangësi, për të cilat nuk janë verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes së akteve administrative, vendimeve të gjykatës apo kalimi nga hipoteka në sistem të kontratave të shitjes, urdhër kufizimeve, etj, mos llogaritje penaliteti për regjistrim me vonesë të këtyre akteve dhe konkretisht për praktikat si më poshtë:

Nga 9 praktika, **6 prej** tyre kanë kryer veprimet e regjistrimit pas 30 ditëve të aktit administrativ dhe nuk janë llogaritur e arkëtuar penalitetet për vonesa në regjistrim në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **për vlerën 1,530,000 lekë që përbën dëm ekonomik** dhe konkretisht:

* Me referencën nr. 0012216, për pasurinë nr. 12/9+1-23, të llojit apartament me sipërfaqe 74 m², është vendosur masë sekuestro me Urdhër regjistruesi nr. 50, date 29.01.2014, por nuk janë llogaritur vonesa në regjistrim të dëshmisë së trashëgimisë në **vlerë 210,000 lekë**.

* Praktika me reference 012174, regjistrim pronësie për pasurinë nr. 11/135, truall + ndërtesë me sipërfaqe 200 m² nga kjo 70.3 m² banese, në pronësi të R. Sh, regjistruar në volum 25, faqe 173, për rastin konkret llogariten 600 ditë vonesa në **vlerë 210,000 lekë**.

* Praktika me reference 0012201; (kodi R2), është kërkuar regjistrimi i Vendimit të Gjykatës me objekt: pjesëtim pasurie nr. 9/76, të llojit truall me sipërfaqe 170 m², volum 19, faqe 61 në pronësi të B. G. etj, vendimi ka marrë formë të prerë me 18.11.2010 dhe është aplikuar me datë 25.03.2014, për rastin konkret llogaritet **vonesa në vlerë 300,000 lekë**.

* Me reference 012309, është regjistruar vendim Gjykate për kthim sendi, për pasurinë nr. 1/265, të llojit truall me sipërfaqe 150 m² dhe pasurinë nr. 1/250, e llojit truall me sipërfaqe 224 m², në pronësi të G. K., për të cilën llogariten **vonesa në vlerë 300,000 lekë**.

* Me referencë 0013055, veprimi (kodi RF2) për regjistrim pronësie sipas kontrate privatizimi apartamenti me sipërfaqe 71.3 m², pasuria nr. 5/12+1-20, pronësi të Shtetit, në volum 25, faqe 244, për rastin konkret llogaritet 600 ditë **vonesa në vlerë 210,000 lekë**.

* Reference 0013398, veprimi (kodi R2), vendim Gjykate, pavlefshmëri juridike, për pasurinë nr. 8/44, truall me sipërfaqe 200 m² nga kjo 95 m² ndërtesë, volum 16, faqe 188, në bashkëpronësi të A. T. etj, në vërtetimin hipotekor nr. 356, datë 03.11.2015 nuk është shënuar ndërtesa 95 m² dhe nuk është hequr kufizimi në KPP, me komente nga regjistruesi.

* Referenca 0013364, për ndarje pasurie nr. 1/276-N2 me kërkesë dhe plan-rilevimi, të llojit njësi me sipërfaqe 167 m², në pronësi të M. Xh., në vërtetimin hipotekor nuk është shënuar marrëdhënia me truallin, sipas dokumenteve të origjinës pasuria nr. 1/276, volum 11, faqe 21. Vendimi i gjykatës për heqje kufizimi duhej trajtuar i veçantë.

* Praktika me reference 0013212, veprimi (kodi R2), regjistrim vendimi i KKP të ish-pronarëve për kthim fizik të një sipërfaqeje prej 500 m², për pasurinë nr. 22/10, në pronësi të E. D., regjistrimi është bërë me urdhër të ish-regjistruesit E. B. sipas plan-rilevimit është bërë për 581 m² (pra 81m² më shumë, pa titull pronësie).

* Referenca 0013077, regjistrim kontratë shitje nga EKB Bashkia Lushnjë për regjistrim dëshmi trashëgimie me vendim gjykate, për pasurinë nr. 6/143, të llojit apartament me sipërfaqe 75 m², në pronësi të K. L. etj, praktika e vitit 2011 që është kryer aplikimi dhe është dorëzuar ne arkiv në janar 2015. Nuk janë paguar penalitete për vonesa në regjistrim, për rastin konkret llogaritet 1000 ditë **vonesa në vlerë 300,000 lekë**, për cilën mban përgjegjësi ish juristi S.K., (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8572 për pasuritë nr. 12/9+1-23, nr. 11/135, nr. 9/76, nr. 1/265, nr. 5/12+1-20, nr. 8/44, nr. 1/276-N2; nr. 22/10 dhe nr. 6/143, deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve përcaktuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

6. Gjetje: Nga auditimi i vendimeve të KVVTP, Prefekti Qarkut Fier për periudhën viti 2014 deri 6 mujori i parë 2016 i ka drejtuar ZVRPP Lushnjë 78 kërkesa për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë së tokës bujqësore, për të cilat nga ana e ZVRPP Lushnjë janë kthyer përgjigje për 66 kërkesa, (ose 84%), nuk ka kthyer përgjigje për 12 kërkesa (ose 16%) me tejkallim afati deri 2 vjet, pasqyruar në tabelën emërtuar “Tabela e korrespondencave midis të KVVTP-ZVRPP, për periudhën 2014 deri 6/mujorin e I-rë 2016, mos veprime këto në kundërshtim me KPA me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, dhe me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme, të Fituara me AMTP”.

Nga auditimi me zgjidhje i dokumentacionit për çdo kërkesë rezulton se, në të gjitha kërkesat parashtrihen të dhënat e mëposhtme për familjet bujqësore dhe nga ZVRPP kërkohet:

a. Gjendja juridike aktuale juridike e AMTP-ve të subjekteve të sipërcituar të shoqëruara me fragmente e hartës sipas HTR si dhe printimin përkatës të parcelave,

b. Mënyrën e përfitimit të pronësisë për subjektet e sipërcituara,

c. Kopje e njëjtësuar me origjinalin e AMTP-ve të subjekteve të sipërcituara,

Ndërsa në të gjitha përgjigjet të konfirmuara nga ZVRPP me shkresën përkatëse jo gjithmonë janë dhënë përgjigje të plota e të sakta, gjë që flet për një performancë të ulët të këtij institucioni (*Trajtuar më hollësisht në faqet 116-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që të inventarizohen dhe çelen dosjet përkatëse për 78 kërkesa për informacion, verifikim, konfirmim të Titujve të pronësisë

së tokës bujqësore të KVVTP drejtuar ZVRPP, duke kthyer shkresat origjinale në arkiv dhe për 12 kërkesa për të cilat nga ana e ZVRPP Lushnjë nuk janë kthyer përgjigje në shkelje të afateve ligjore, të zbatohen procedurat dhe të fillojë pasqyrimi në KPP deri në zgjidhjen e plotë ligjore për regjistrimin e pasurive bujqësore, të kthimit të përgjigjeve, të pasqyrohen ngjarjet në KPP dhe të bëhet bllokimi i transaksioneve.

Brenda muajt Mars 2017

7. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në një rast, në ZK nr. 8572 qyteti Lushnjë ka regjistruar referencën nr. 012272, në volum 25, faqe 209 në emër të R. H. dhe është lëshuar vërtetim pronësie nr. 135, datë 16.05.2014, për pasurinë nr. 11/253 në llojin e pasurisë truall me sipërfaqe 200 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 97 m² ndodhur në lagjen “Gafurr Muça” Lushnjë, sipas nenit 25/b, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, por mungon dokumentacioni i kërkuar në zbatim të VKM nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme”, për këtë praktikë mungojnë:

- dokumentacioni ligjor për marrjen e vendimit për pasurinë nr. 11/53, sipas kërkesave të nenit 25/b, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.
- nuk ka shpallje për 45 ditë të kësaj pasurie, që të jetë e dokumentuar me procesverbal
- nuk ka urdhër regjistruesi për krijimin e komisionit për hartimin e relacionit të kërkesës dhe për rrjedhojë nuk ka relacion nga grupi punës për verifikimin e pronës;
- nuk ka vendim nga komisioni i miratuar prej regjistruesit për këtë pasuri.
- nuk ka asnjë dokument hipotekor që të vërtetojë pronësinë pa sipërfaqe.
- nuk ka fragmente harte të vitit 1972 për pasurinë 11/253, veprime në papajtueshmëri me nenin 25, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 118-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi në ZK nr. 8572 për pasurinë nr. 11/253, v. 25, faqe 209, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Mars 2017

8. Gjetje: Nga auditimi në lidhje me regjistrimin e pronave të transferuara sipas VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, doli se, sipas VKM-së, për Bashkinë Divjakë kanë kaluar 41 burime ujore si rezervuar, stacione pompimi dhe USHF pa sipërfaqe, ndërsa kanale të para dhe të dyta 84 km; për Bashkinë Lushnjë kanë kaluar 27 burime ujore si rezervuar, stacione pompimi dhe USHF pa sipërfaqe, ndërsa kanale të para dhe të dyta 111 km dhe 803 km kanale të treta.

Për sa më lart del që këto vepra ujore, nuk janë marrë në dorëzim nga ana e këtyre Bashkive, pasi deri në momentin e këtij auditimi nuk është kryer asnjë veprim për regjistrimin në favor të tyre, veprime këto në kundërshtim me pikat 2, 3 dhe 4 të VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, sipas pasqyrës emërtuar “Gjendja e sipërfaqeve të rezervuarve sipas inventarit të digave në R.Sh dhe sipas KPP të çelura dhe administruara nga ZVRPP Lushnjë”.

Në lidhje me evidentimin, regjistrimin e rezervuarëve dhe problematikat e dala konstatohen:

- Për Bashkinë Lushnjë, evidentohen 17 rezervuar ku sipas KPP, nga Njësia e Menaxhimit të Projektit janë çelur me nr. pasurie dhe sipërfaqe, por doli se ka mos përputhje të emrit të rezervuarit sipas VKM me atë në fakt. Nuk përfshihen në informacion rezervuari Tataj, ndërsa nuk përfshihet në VKM rezervuari Gjyshaj dhe rezervuari Gjuzaj në ortofoto është i tharë, ndërsa nga Njësia e Menaxhimit ky rezervuar është çelur në zërin kadastral “arë”.

Nga ana e Bashkisë Lushnjë nuk janë marrë në dorëzim rezervuari Thanë që është një pikë turistike, për të cilën janë kryer 1.9 milion Euro investim nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të dhëna të marra sipas artikullit “Për sigurinë e digave në përputhje me standarde ndërkombëtare”, të datës 02.02.2016.

- Për Bashkinë Divjakë, për rezervuarin Kryekuq 2 nuk është çelur KPP, rezervuari Shenkollas 1, fshati Hallvaxhias është pa ujë, rezervuari Bishcukas, fshati Bishcukas, Fier-Seman në fshatin Fier-Seman dhe Gërmenj i Madh në fshatin Gërmenj nuk janë në VKM.

- pothuajse të gjitha veprat kanë mospërputhje të sipërfaqeve, pasi në VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, nuk është bërë kalimi duke përshkruar sipërfaqen për çdo vepër ujore.

Këto mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe pikën 6, 7 të VKM nr. 567, datë 14.7.2010 “Për Transferimin e Rezervuarve dhe Skemave Ujitëse Përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në Pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe për një Ndryshim në Vendimin nr. 1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të Bordeve të Kullimit, të cilat i Kalojnë në Përgjegjësi Administrimi MBUMK”, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 126-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë në bashkëpunim me Bashkitë Lushnjë dhe Divjakë të bëjnë identifikimin e pasurive dhe pronave të transferuara sipas VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, si dhe regjistrimin në favor të këtyre Bashkive.

Brenda muajt Mars 2017

9. Gjetje: Nga auditimi me zgjedhje në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e kontratave të qirave të lidhura nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) dhe doli se për periudhën në auditim janë dorëzuar në 4 raste dhe konkretisht:

- Nga MBZHRAU-ja është lidhur kontratë qiraje nr. 2150 dhe rep nr. 751 kol, datë 23.10.2015, me Shoqërisë “A” ShPK, për sipërfaqen prej 68.7396 ha në fshatin Zhamë Sektor në ZK nr. 3916. Kjo Ministri nuk është pajisur me kartela të pasurisë në emër të saj, me të drejtë përdorimi të këtyre pronave, pra dhe të dispononte të drejtën e lidhjes të kësaj kontrate qiraje. Kontrata e qirasë është regjistruar sipas referencë nr. 0766, në ZK 3916, Zhamë sipas KPP.

- Nga MBZHRAU-ja është lidhur kontratë qiraje me Shoqërisë “A” ShPK me datë 30.01.2015 për një sipërfaqe toke bujqësore 28.42 ha e cila ndodhet në fshatin Ngurrëz e Vogël, ZK nr. 3060 fshati Kamcishte dhe nuk rezulton të jetë hapur kartela të pasurive të paluajtshme pas regjistrimit fillestar për këtë ZK për ngastrat me nr. 153, 154, 155, 157.

Përsa përshkruam më lart del se janë dhënë me qira pasuri të cilat nuk rezultojnë të regjistruara në asnjë ZK. Kjo kontratë qiraje, ende nuk është pasqyruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

- MBZHRAU-ja me shkresë nr. 2224, datë 21.03.2016 ka dërguar në ZVRPP Lushnjë për regjistrim kontratën nr. 1824, datë 03.03.2016 të lidhur nga ana e saj me Shoqërinë “A” shpk për një sipërfaqe toke bujqësore prej 87 ha e cila ndodhet në fshatin Karavasta, Komuna Remas, Lushnjë, ZK nr. 2084 e përbërë prej ngastrave 151/1, 151/4, 152/1, 153/1, 153/6, 157/1, 155/1, 155/5, 156/1, 158/1, 159/1, 160/1.

ZVRPP Lushnjë këtë kontratë qiraje nuk e ka regjistruar pasi pasuritë e përshkruara në kontratë, janë pasuri që ndodhen në ZK 2085 fshati Karavasta e Re dhe jo ZK nr. 2084.

MBZHRAU-ja nuk zotëron certifikatë përdorimi apo pronësie të lëshuar nga ZVRPP Lushnjë si dhe pasuritë e sipërcituara, në bazë të VKM nr. 575 date 28.05.2008, janë dhënë në pronësi të ish-komunës Remas. Në lidhje mbi sa më lart regjistrimi i kësaj kontrate do të

krijonte mbivendosje të pasurive, veprim në papajtueshmëri me nenin 28, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit” dhe së dyti këto pasuri janë të kufizuara, pra nuk ndodhen të lira për kryerje veprimesh.

- MBZHRAU-ja, ka lidhur kontratë qiraje me akt noterial nr. 1254 rep dhe nr. 350/1 kol, datë 28.05.2015, me Shoqërinë “D” ShPK për një sipërfaqe toke bujqësore prej 16.93 ha, me afat 60 vjet, e cila ndodhet në fshatin Gjazë, ZK 1767 e përbërë nga ngastrat me nr. pasurie 583, 584, 585, 586, të saktësuara sipas dokumentacionit që ndodhet në referencë nr. 0376, Njësia administrative Krutje, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.

Në përfundim, në të gjitha KPP seksioni “D” është bërë shënimi Kontratë qeraje të noterit “Xh.P” në favor të qiramarrësit “D” ShPK, Në lidhje me këtë kontratë konstatohet se ajo është lidhur nga MBZHRAU, pa i patur në administrim këto pasuri.

Të gjitha kontratat e lidhura nga MBZHRAU-ja, vijnë në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil, pasi kjo Ministri nuk disponon titull pronësie, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me VKM nr. 45, datë 29.1.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Fondit të Tokës Bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj Ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 129-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë në bashkëpunim me MBZHRAU dhe organet e pushtetit vendor, Bashkitë Lushnjë e Divjakë të bëjnë identifikimin e pasurive objekt i secilës kontratë, në ZK nr. 3916 për kontratë qiraje nr. 2150 dhe rep nr. 751 kol, datë 23.10.2015, me Shoqërisë “A” shpk, për sipërfaqen prej 68.7396 ha; në ZK nr. 3060 fshati Kamcishte për kontratë qiraje me Shoqërisë “A” ShPK me datë 30.01.2015 për një sipërfaqe toke bujqësore 28.42 ha e cila ndodhet në fshatin Ngurrëz e Vogël, në ZK nr. 2084, për kontratë qiraje nr. 1824, datë 03.03.2016 me Shoqërinë “A” ShPK për një sipërfaqe toke bujqësore prej 87 ha dhe ZK nr. 1767, për kontratë qiraje me akt noterial nr. 1254 rep dhe nr. 350/1 kol, datë 28.05.2015, me Shoqërinë “D.” ShPK për një sipërfaqe tokë bujqësore prej 16.93 ha, pasi kjo Ministri nuk disponon titull pronësie për këto pasuri, si dhe të kryejnë regjistrimin në pronësi në zbatim të VKM nr. 45, date 29/01/2014 “Për Kalimin në Administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Fondit të Tokës Bujqësore të Ish-Ndërmarrjeve Bujqësore dhe Ish-Institucioneve Kërkimore-Shkencore të kësaj Ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, me synim sigurimin, administrimin e pasurive shtetërore, e cila është bërë objekt i kontratave të qirave si dhe ruajtjen dhe garantimin e investimeve të kryera nga investitorët.

Brenda muajt Mars 2017

10. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se në ZVRPP Lushnjë u konstatua një pamjaftueshmëri e nivel i ulët të performancës së punës e shprehur në:

-Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat arrijnë mbi 416 raste, ndërsa të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar arrijnë 496 mijë lekë, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Lushnjë ndaj publikut, mos administrimin në arkiv të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, sipas **Aneksit 1** “Përmbledhëse e praktikave të pa përpunuara dhe në proces të pa përfunduara sipas viteve”, në papajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”,

- pamjaftueshmërinë e performancës lidhur me mungesën e një rregullore të brendshme të funksionimit të administratës së ZVRPP Lushnjë, të miratuar nga Kryeregjistruesi për

periudhën e mëparshme, lidhur me faktin se Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhet përmbledhur e bërë e plotë, por nuk ka si objekt funksionimin e administratës të ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,

- nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi, shërbimit të IT dhe sidomos lidhur me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve lidhur me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, si dhe lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces, evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj. Pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 136-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë, të marrë masat për inventarizimin e dokumentacionit, të kryejë kontrollin ligjor të rregullshmërisë së mbetjes në proces dhe të evadohen aplikimet prej 416 praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej 5 vitesh deri në vitet 2015, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht 496 mijë lekë, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Lushnjë ndaj publikut dhe të inventarizohen administrohen në arkiv dokumentacioni përkatës i praktikave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, sipas **Aneksit nr. 1** “Përmbledhëse e praktikave të pa përpunuara dhe në proces të pa përfunduara sipas viteve”.

Brenda muajit Mars 2017

11. Gjetje: Nga auditimi rezulton se në ZVRPP Lushnjë mungonin referencat e ZK nr. 8572 në praktikën e privatizimit të objektit “Kinema verore” sipas vërtetimit hipotekor nr. 467, datë 04.07.1994 në emër të trashëgimtarëve të familjes P. dhe në ZK nr. 3268, fshati Savër referenca nr. 01006, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, pikën 2.6, kreu III, të Rregullores nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 1436, datë 02.11.2010 “Për procedurën e mbajtje së azhurnuar në mënyrë digjitale të dokumentacionit të ZK që kalojnë regjistrimin fillestar”, ligjit nr. 33/2012 datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 147-1481 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, për arkivimin e referencave të punuara e të pa dorëzuara nga specialistët në arkivin e institucionit.

Brenda muajit Mars 2017

12. Gjetje: ZVRPP Lushnjë, nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të dërguara respektivisht me shkresat nr. 420/6, datë 28.09.2012, pasi nga auditimi janë konstatuar raste të mos zbatimit të tyre, raste të mos nxjerrjes së urdhrave

kufizuese dhe mos pasqyrimi i tyre në regjistrat e ZVRPP, duke sjellë për pasojë lejimin dhe kryerjen e transaksioneve, mbi pasuri të përfituara në mënyrë të kundërligjshme nga poseduesit e tyre apo regjistruara në mënyrë të kundërligjshme nga institucioni, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe në ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 7-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të evidentojë të gjitha pasuritë për të cilat KLSH ka rekomanduar masa kufizuese por që ende rezultojnë të pa kufizuara, pa pasur një ngjarje ligjore për të përligjur procedurat dhe të veprojnë sipas referencave të mësipërme.

Brenda muajit Mars 2017

13. Gjetje: ZVRPP Lushnjë nuk ka një evidentim, ndjekje dhe informim brenda stafit të saj për pronat e regjistruara me mbivendosje, të cilat u evidentuan nga auditimi me zgjedhje në 4 raste, për disa pasuri të llojit truall, të regjistruara me mbivendosje, kryesisht ndaj pronës shtetërore dhe ndaj pronave private, në kundërshtim me ligjin nr. 33/12, datë 21.03.2012 dhe me aktet e tjera nënligjore dhe konkretisht:

- Në ZK 8572, evidentimi i pasurisë nr. 8/147, volum 24, faqe 229, me **mbivendosje për sipërfaqen 30 m²**, që vjen si rezultat i hedhjes në hartën e punës së dy vendimeve të ish-komisionit të KK Pronave nr. 13, datë 11.12.1994 të familjes L dhe nr. 103, datë 29.09.1994 të familjes P;

- Në ZK 8572, evidentimi i pasurisë nr. 18/17, volum 24, faqe 117, me **mbivendosje për sipërfaqen 40 m²**, nga krahasimi i gen-planit të kësaj sipërfaqeje për lejen e legalizimit nr. 43122, date 20.11.2012 dhe punimit në hartën e punës së zyrës del se ka zhvendosje në hartë duke u **mbivendosur me pasurinë shtet të llojit kanal**, sipas dokumentacionit të referencë nr. 09938;

- Në ZK nr. 8572, nga regjistrimi i tokave bujqësore brenda juridiksionit të qytetit, rezultoi që në 1 rast është regjistruar sipërfaqja 9900 m², në hipotekë nr. 216, datë 08.08.2014, pa zbatuar procedurat e kërkuara në zbatim të Rregullores nr. 61, datë 02.08.1999 “Për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme në raste të veçanta”. Gjithashtu u bë krahasimi i plan rievimit dhe hartës së zyrës që është hedhur pasuria, në të cilën rezultoi se është bërë një spostim sipas pozicionit hartografik, duke u prishur dhe spostuar për korrigjim sipërfaqeje, pa urdhër regjistruesi dhe si e tillë **krijohet një mbivendosje me sipërfaqe prej 917 m²**, veprim në kundërshtim me UKM nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre dhe që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit”.

- Në ZK nr. 2084, nga MBZHRAU-ja është dhënë me qira një sipërfaqe toke bujqësore prej 87 ha, sipas kontratës nr. 1824, datë 03.03.2016 të lidhur nga ana e saj me Shoqërinë “A.” ShPK e përbërë prej ngastrave 151/1, 151/4, 152/1, 153/1, 153/6, 157/1, 155/1, 155/5, 156/1, 158/1, 159/1, 160/1. Këto sipërfaqe në bazë të VKM nr. 575 date 28.05.2008, janë dhënë në pronësi të ish-komunës Remas. Për sa më lart konstatohet se regjistrimi i kësaj kontrate do të **krijonte mbivendosje të pasurive**.

Për të katër rastet, veprimet janë në papajtueshmëri me nenin 28, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 126-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa për identifikimin dhe evidentimin e pasurive të regjistruara me mbivendosje dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore në zbatim të përcaktimeve të pikës 3, neni 37, neni 59 dhe pika 1 e nenit 60 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të bëjë njoftimin e palëve, Zyrën e Avokatit të Shtetit, kur rasti lidhet me pronë shtetërore, për ndjekjen e procedurave ligjore *për zgjidhjen e mbivendosjes* lidhur me pasuritë rezultuara me mbivendosje.

Brenda muajit Mars 2017

14. Gjetje: Nga ZVRPP Lushnjë për 10 subjekte u konstatuan të jenë regjistruar pasuri të përfituara nga Ligji “Për urbanistikën”, sipas të lejeve të ndërtimit me mangësi e shkelje në lidhje arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga mosaplikimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë (për diferencën Preventiv-situacion) *në vlerën prej 7,021,705 lekë* dhe mos aplikimi i taksës së kalimit të pronësisë për sipërfaqet e përbashkëta në vlerën *5,503,385 lekë*. Nuk rezulton të ketë oponencë teknike për vlerën e preventivit mi 100 milion lekë, mungojnë aktet e kontrollit, mungon marrja në dorëzim e infrastrukturës inxhinierike. Ky veprim është në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 70-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP-së Lushnje të marrë masa për nxjerrjen e urdhrat të kufizimit të pasurisë regjistruar sipas *referencave 11537, 08467, 08665, 09316, 09424, 09435, 09927, 09831, 10119, 10785* për shkeljet e konstatuara, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve përcaktuar në këtë Raport Auditimi dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

15. Gjetje: ZVRPP Lushnje për 1 subjekt me referencën nr. 10937 ka regjistruar ndërtesë në emër të R. S. pasurinë 24/ 69, ND-lokal tregtie 1 kat dhe banesë 6 kate, në shkelje të kondicioneve urbanistike, pjesërisht në truall shtetëror dhe mbi kanal vaditës, në kundërshtim me ligjin e urbanistikës 8405, datë 17.09.1998 i ndryshuar, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 dhe me ligjin 10119, datë 23.09.2004 “Për planifikimin e Territorit, me ndryshimet e mëvonshme (*Trajtuar më hollësisht në faqet 70-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP-së Lushnje të marrë masa për nxjerrjen e urdhrat të kufizimit të pasurisë regjistruar sipas *referencës nr. 10937 në emër të R. S.*, për shkeljet e konstatuara, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

16. Gjetje: ZVRPP Lushnje në 3 raste sipas *referencave 11430, 11438, 11338 dhe 11171* ka regjistruar kontrata nga Enti Kombëtar i Banesave dhe nga Ministria e Ekonomisë, nga të cilat në një rast nuk rezulton të jenë përcaktuar marrëdhëniet e Pronësisë me truallin, në kundërshtim me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nr. 7843, datë 13.07.1994, pika 7 e rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, ndërsa dy raste u morën në konsideratë sipas observacioneve, ndërsa në 1 rast sipas *referencës nr. 11171* është regjistruar kontratë shitje nga Ministria e Ekonomisë nr. 1785/418, datë 22.05.2000 (shitje me Rezervë nga DASHP Ministria e Financave) në regjistrin hipotekor nr. 127, datë 13.02.2001. Në *Nenin 5*, të

kontratës së privatizimit nr. 1785/418, datë 22.05.2000 (shitje me Rezervë nga DASHP Min. Financave) evidentohet sipërfaqja 169 m² e cila ka mbetur në pronësi shtet dhe pala blerëse duhet të kishte arkëtuar detyrim nga arkëtimi i qirasë pranë seksionit të Financës Këshillit Rrethit Lushnje. Regjistrimi i kësaj kontrata është bërë në kundërshtim me rregulloren nr. 184, datë 04.08.1999, Kreu IV-të, pika 7 pa u përcaktuar më parë marrëdhëniet e pronësisë së truallit dhe deri në fund të vitit 2015 duhet të ishte arkëtuar detyrimi nga qiraja për **2,190,240 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 95-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: ZVRPP Lushnje, Regjistruesi në 1 rast të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin të kufizimit në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” për pasurinë e regjistruar sipas referencë nr. 11171, për shkeljet e konstatuara deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur Ligjor dhe shlyerjen e detyrimit të përcaktuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Brenda muajit Mars 2017

17. Gjetje: Nga ZVRPP Lushnje në një rast me referencën 09424 është regjistruar leje ndërtimi në emër të F. T. bazuar në pronësinë regjistruar me nr. hipotekor nr. 158, datë 19, datë 19.04.2006 për 686 m², që rrjedh nga një akt-shitje nga seksioni i financës datë 06.12.1994 dhe jo nga Departamenti Administrimit dhe shitjes së Pronës publike, mbasi F. T. sipas kontratës nr. 788, datë 25.10.1993 ka privatizuar Kinema Dimërore dhe trualli është me qira. Një vit pas privatizimit të objektit ka blerë truallin dhe sipas vlerësimit të qirasë prej 404 dollarë në muaj, për 12 muaj deri në momentin e shitjes duhet të kishte **paguar 4848 dollarë** ose vlerësuar me kursin e këmbimit **601,152 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 95-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP-së Lushnje të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin të kufizimit në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” për pasuritë e regjistruara sipas referencës nr. 09424, për shkeljet e konstatuara deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor dhe shlyerjen e detyrimit të përcaktuar në Raport Përfundimtar Auditimi.

Brenda muajit Mars 2017

18. Gjetje: Nga ZVRPP Lushnje në 1 rast sipas referencës 11054, është regjistruar me leje legalizimi një sipërfaqe trualli prej 3004 m² dhe ndërtim 1091 m² për objekt me 3 kate nëntokë dhe dy kate mbi tokë, bazuar në vërtetimin hipotekor nr. 302, datë 07.10.2014 për 4000 m² Ullishtë plotësuar nga B. K. Në origjinë kjo sipërfaqe rrjedh nga AMTP nr. 27015 në përdorim pasuria 25/3 për 4000 m² Ullishtë, ndërsa sipas observacioneve dërguar nga ZVRPP Lushnje rezulton që me shkresën nr. 3777, datë 30.09.2014 bashkëlidhur është dërguar konfirmim i AMTP për kalimin në pronësi të pasurisë 25/3 ish në Përdorim. Regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në shkelje të procedurave për kalimin në pronësi, **në zbatim të ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 nuk kalon në pronësi pasuritë e përfutuara në përdorim kur këto sipërfaqe ndodhen brenda vijave kufizuese.** Në bazë të ligjit 171, datë 18.12.2014 pika 2, shkronja ii Përrjashtohen nga kalimi në pronësi sipërfaqet që përfshihen në procesin e legalizimit dhe sipas nenit 3 të ligjit këto sipërfaqe duhet të përdoren vetëm për veprimtari Bujqësore. Për kalimin në pronësi të sipërfaqes prej 4000 m² Ullishtë në favor të F.P nuk ka vendim të këshillit të Qarkut (Trajtuar më hollësisht në faqet 106-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP-së Lushnje të marrë masa nxjerrjen e urdhrin të kufizimit të pasurisë së regjistruar sipas referencës 11054, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive

të Paluajtshme” për shkeljet e konstatuara dhe të kërkojë në institucionet përkatëse në lidhje me përcaktimin e statusit ligjor të kësaj pasurie, plotësimin e dokumentacionit, në të kundërt të kërkojë arkëtimin i detyrimit i llogaritur në vlerën prej *vlerën 30,068,000 lekë*, me statusin e truallit shtetëror.

Brenda muajit Mars 2017

19. Gjetje: ZRVPP Lushnje në **6 raste** sipas referencave **nr. 10211, 10271, 10824, 10924, 11051 dhe 11167**, ka regjistruar truall me nenin 24/b pa dokumentacion ligjor pronësie të truallit dhe në kundërshtim me urdhrin e K/Regjistruarit nr. 37, datë 06.06.2006, nenin 193 Kodit Civil dhe Udhëzimin nr. 1, datë 31.01.2007 të KM “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 121-126, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: **ZVRPP Lushnje, Regjistruesi në 5 rastet** e evidentuara në këtë Projekt raport sipas referencave nr. **nr. 10211, 10271, 10824, 10924, 11051** të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin të kufizimit në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” për shkeljet e konstatuara deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur Ligjor

Brenda muajit Mars 2017

20. Gjetje: **ZVRPP Lushnje** sipas referencës **11167**, datë 26.06.2015 ka regjistruar ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 138 m², pa dokumentacion ligjor pronësie, vetëm me një vendim të Komitetit Ekzekutiv nr. **nr. 46, datë 29.09.1990**, në kundërshtim me nenin 193 të kodit civil, nenin 24, të ligjit 33/2012, me rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, urdhrin nr. 1400, datë 25.10.2010 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 95-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: **ZVRPP Lushnje, Regjistruesi në 1 rast** i evidentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi sipas referencës nr. **11167**, për shkeljet e konstatuara, të marrë masa për nxjerrjen e urdhrin të kufizimit në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” deri në përcaktimin dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor

Brenda muajit Mars 2017

21. Gjetje: **Në 2 raste** janë regjistruar pasuri të paluajtshme publike sipas referencave **10949 dhe 11329** me VKM për transferim në pronësi të Bashkisë, por në dokumentacionin e regjistrimit nuk janë bashkëlidhur Urdhrat e Ministrit të Pushtetit Vendor në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 95-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP-së Lushnje në dy rastet e konstatuara sipas referencave **10949 dhe 11329**, të kërkojë pranë organeve përkatëse dhe të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjes me urdhrat e Ministrit të Pushtetit Vendor, për transferimin në pronësi dhe të regjistrohet sipërfaqja prej 179 m² e pa veçuar shtet.

Brenda muajit Mars 2017

22. Gjetje: ZVRPP Lushnje në **3 raste**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie, për pasuritë e përfituara sipas AMTP-ve: nr. 9819, 4440, **të cilët janë kopje**, duke ligjëruar në këtë mënyrë kryerjen e veprimeve për regjistrimin e një sipërfaqe totale prej 31034 m², e cila rrjedh nga akte absolutisht të pa vlefshme. *Gjithashtu ZVRPP-ja, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, bashkisë dhe DAMT-it, pranë Këshillit të Qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqesin në ZVRPP, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “b” pika 4, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë*

e paluajtshme të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 1, ZK 2790, ZK 2789, ZK 1755, (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Mars 2017

23. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **3 raste**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie, për pasuritë e përfituara sipas AMTP-ve: nr. 9735, 9824, 9719, të cilat janë kopje të pa njësuar plotësisht me origjinalin, pasi nuk ka datën dhe vitin e njësimit, mungon vula e thatë, nënshkrimi i noterit, noteri nuk përcakton kush e ka paraqitur dokumentin për njësimit, duke ligjëruar në këtë mënyrë kryerjen e veprimeve për regjistrimin e një sipërfaqe totale prej 77223 m² arë, e cila rrjedh nga akte absolutisht të pa vlefshëm. Gjithashtu ZVRPP-ja, nuk ka kryer verifikimet nëse pasuritë, pjesë përbërëse të këtij akti, krijojnë mbivendosje me pasuri tjetër, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me nenin 56, shkronjën “e” nenin 67 Ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar shkronjën “ç” pika 2.2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”. Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 1, ZK nr. 2790 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Mars 2017

24. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **10 raste**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasuritë e përfituara sipas AMTP-ve: nr. 9831, 9802, 9796, 9706, 9728, 10068, 10084, 4492, 8658, **të cilat mungojnë**, me sipërfaqe totale 162049 m² arë, duke ligjëruar në këtë mënyrë kryerjen e veprimeve absolutisht të pa vlefshme. Gjithashtu ZVRPP-ja, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, bashkisë dhe DAMT-it, pranë Këshillit të Qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqesin në ZVRPP, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “b” pika 4, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”. Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”, (*Trajtuar në faqet 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”,

bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 1 dhe nr. 2, ZK 2790, ZK 2789, ZK 1755, ZK 3105 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Mars 2017

25. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie, për pasurinë nr. 109/31, volum 2, faqe 141 përfituar sipas AMTP nr. 8656 *i cili është kopje*, si dhe nuk është bërë saktësimi i sipërfaqeve LN/ AMTP, duke përfituar më tepër një sipërfaqe prej 546 m², Gjithashtu ZVRPP-ja, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë dhe komunës/bashkisë për të bërë saktësimin e planvendosjes sipas sipërfaqes së çdo pasurie të dhënë në AMTP. Veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç” pika 2, shkronjën “d” pika 2.2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, *(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim: ZVRPP Lushnjë, Regjistruesi të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 2, ZK 3105 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Mars 2017

26. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 114/11, volum 1, faqe 43 përfituar sipas AMTP nr. 483, akt i cili *nuk i është nënshtruar procesit të saktësimit të sipërfaqeve LN/ AMTP, duke përfituar më tepër një sipërfaqe prej 4617 m²*. Gjithashtu ZVRPP-ja, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë dhe komunës/bashkisë për të bërë saktësimin e planvendosjes sipas sipërfaqes së çdo pasurie të dhënë në AMTP. Veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “d” pika 2.2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, *(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim: ZVRPP Lushnjë, Regjistruesi të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 2, ZK 3106 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Mars 2017

27. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie, për pasurinë nr. 131/24, volum 2, faqe 149 përfituar sipas AMTP nr. 591 i cili është në dy kopje origjinale dhe tre pasuri me të njëjtën numër dhe sipërfaqe, pjesë përbërëse të këtij akti, *dublojnë njëra tjetrën duke dyfishuar sipërfaqen si rezultat, është përfituar tepër 5980 m²*. Gjithashtu ZVRPP, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë dhe komunës/bashkisë për të bërë saktësimin e planvendosjes sipas sipërfaqes së çdo pasurie të dhënë në AMTP, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “d” pika 2.2, të UKM nr.

2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ZVRPP Lushnjë, Regjistruesi të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 2, ZK 3106 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Mars 2017

28. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie, për pasurinë nr. 128/29, volum 2, faqe 22 përfituar sipas AMTP nr. 558, për të cilin **nuk është bërë saktësimi i sipërfaqeve LN/ AMTP, duke përfituar më tepër një sipërfaqe prej 4063 m²**. Gjithashtu ZVRPP-ja, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë dhe komunës/bashkisë për të bërë saktësimin e planvendosjes sipas sipërfaqes së çdo pasurie të dhënë në AMTP, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “d” pika 2.2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ZVRPP Lushnjë, Regjistruesi të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e pasqyruara në tabelën nr. 2, ZK 3106 (bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Brenda muajit Mars 2017

29. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 458/90, volum 41, faqe 227, në kushtet kur leja e ndërtimit i referohet sheshit të ndërtimit nr. 3 datë 25.04.2006, i cili nuk ndodhet në dosje, akti i kolaudimit nuk është i nënshkruar nga investitori. Gjithashtu në dosje mungon studimi urbanistik pjesor i miratuar. Këto veprime janë në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikat c dhe e të nenit 20, nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, me pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit “Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve”, dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar në faqet 91-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 458/90, volum 41, faqe 227, ZK 1492 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

30. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 437/26-a, truall me sipërfaqe 629 m² dhe 178 m² ndërtesë volum 33, faqe 134, në

kushtet kur leja e ndërtimit i referohet sheshit të ndërtimit nr. 4 datë 24.09.2007, i cili nuk ndodhet në dosje, formulari nr. 4 nuk përcakton subjektin ndërtues, në aktin e kolaudimit që nuk është i nënshkruar nga investitori citohet se “me vendimin nr. 3 dt 28.02.2006 të KRRT është miratuar leja e ndërtimit”, ndërkohë që leja e ndërtimit e paraqitur për tu regjistruar mban numrin 4 datë 24.09.2007, vlera e objektit sipas preventivit e vendosur në akt kolaudimi nuk përputhet me vlerën e preventivit që administrohet në dosje. Gjithashtu në dosje mungon studimi urbanistik pjesor i miratuar. Këto veprime janë në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikat c dhe e të nenit 20, nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, me pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit “Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve”, dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 91-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 437/26-a, volum 33, faqe 134, ZK 1492 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Mars 2017

31. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 699/71, truell me sipërfaqe 315 m² dhe 288 m² ndërtesë volum 51, faqe 43, në kushtet kur në formularin nr. 4 nuk përcaktohet subjekti ndërtues, nuk përcaktohet afati i lejes, mungon data e zbardhjes së lejes. Në formularin nr. 2 sipërfaqja e sheshit është 350 m² ndërsa në dokumentin e pronësisë posedohet 315 m² me një diferencë prej 35 m², gjithashtu në dokumentin e pronësisë rezulton të jetë një objekt 86 m² për të cilin nuk ka leje për prishjen e tij. Leja e përdorimit nuk përputhet me lejen e ndërtimit, pasi në të objekti përcaktohet si “Lokal 1 Kat” ndërsa në lejen e ndërtimit objekti është “Shtëpi banimi dhe lokal 3 kat”. Në aktin e kolaudimit sipërfaqja e ndërtimit është 272 m² ndërsa në formularin nr. 2 sipërfaqja e ndërtimit është 288 m², pra kanë mospërputhje. Gjithashtu në dosje mungon studimi urbanistik pjesor i miratuar, veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikat c dhe e të nenit 20, nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, me pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit “Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve”, dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 91-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 699/71, volum 51, faqe 43, ZK 1492 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Mars 2017

32. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 14/20-Nd, me sipërfaqe 100 m², volum 6, faqe 126, në kushtet kur formulari nr. 4 leja e ndërtimit, nuk i referohet vendimit për shesh ndërtimi nr. 25, dt 06.11.2009, leja e ndërtimit është miratuar në kushtet kur lejes së sheshit të ndërtimit i ka përfunduar afati, gjithashtu në formularin nr. 4 nuk përcaktohet subjekti ndërtues, nuk përcaktohet afati i lejes, mungon data e zbardhjes së lejes. Në dosje mungojnë: Dokumenti i pronësisë marrëdhëniet me truallin, ku personi juridik ndërtues duhet të paraqesë kontratën e lidhur me pronarin e tokës ose me personin që ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja. Veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikat c dhe e të nenit 20, nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, me pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit “Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve”, dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 91-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 14/20-Nd, volum 6, faqe 126, ZK 2789 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Mars 2017

33. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 630/108-N1, volum 53, faqe 138, në kushtet kur, është regjistruar fillimisht trualli dhe më pas është kryer fshirje fizike mbi kartelë (KPP), gjithashtu ka ndryshim të zërit kadastral nga shesh në ndërtesë, pa një vendim të një organi kompetent që ka tagrin për kryerjen dhe nxjerrjen e akteve që bëjnë të mundur ndryshimin e zërit kadastral. Në dosje mungojnë: Leja e përdorimit, dokumenti i pronësisë marrëdhëniet me truallin, ku personi juridik ndërtues duhet të paraqesë kontratën e lidhur me pronarin e tokës ose me personin që ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja”, veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikat c dhe e të nenit 20, nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, me pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit “Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve”, dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 91-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 630/108-N1, volum 53, faqe 138, ZK 1492 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajt Mars 2017

34. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë nr. 449/14, volum 2, faqe 138, Pus Naftë me sipërfaqe 850 m², në kushtet kur: Akti i cili ka sjell ndryshim dhe ose përfitim të të drejtave të pronësisë, në këtë rast “Urdhri i Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit nr. 614, prot datë 28.12.2001” **është kopje, i cili nuk përmban të dhënat për vlerën, kufijtë, sipërfaqen dhe vendndodhjen e pasurisë së paluajtshme.** Urdhri nr. 614, prot datë 28.12.2001 **është lëshuar përpara VKM nr. 219 datë 16.04.2004** “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të pa luajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrim “A. ”. Gjithashtu ky vendim **nuk ka bashkëlidhur listën e pronave e cila përbëhet nga 180 fletë. Në dosje mungon: Plan rilevimi, planimetria e objekteve (struktura e pusit).** Këto veprime janë në papajtueshmëri me pikën a neni 25, pika 2 neni 45 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 dhe 3 të VKM nr. 553, datë 28.8.1998 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Shoqërive Tregtare, të Krijuara nga Transformimi i Ndërmarrjeve Shtetërore” (trajtuar në faqen 135-136 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 neni 5, pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 449/14, volum 2, faqe 138, ZK 1755 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2017

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua, se në 5 zona kadastrale: Kamçisht, Imshte, Kolonjë, Lifaj i Ri, Zhelizhan, janë regjistruar tokë “**Truall**” dhe “**Ndërtesë**” në zonat urbane të fshatrave, në një kohë që nuk ka listë nga pushteti vendor: “Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive” dhe as dokumentacion tjetër, si leje ndërtimi, plan vendosje, etj., por pasuritë “Truall” janë regjistruar bazuar në AMTP-të dhe pasuritë “Ndërtesë” bazuar vetëm në LN-të.

Kështu rezulton se në këto 5 zona kadastrale, janë regjistruar gjithsej **273 pasuri** me një sipërfaqe **65679 m² “Truall”** dhe **15797 m² “Ndërtesë”** në zonat urbane të fshatrave dhe konkretisht: ZK Kolonjë: 49 pasuri për sipërfaqen “Truall” 9850 m², “Ndërtesë” 1447 m²; ZK Kolonjë qendër urbane: 47 pasuri, “Truall”: 11760 m² dhe “Ndërtesë”: 3337 m²; ZK Kamçisht: 42 pasuri, “Truall” 7869 m², “Ndërtesë” 3376 m²; ZK Imshte: 76 pasuri, “Truall” 24800 m², “Ndërtesë” 4265 m²; ZK Lifaj i Ri: 15 pasuri, “Truall” 3000 m², “Ndërtesë” 1139 m²; ZK Zhelizhan: 15 pasuri, “Truall” 8400 m², “Ndërtesë” 2233 m²;

Këto veprime janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, Kreu IV, pika 13 dhe me urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 3191, datë 11.05.2012 “Unifikimi i procedurave të regjistrimit të pasurive “Truall+Ndërtesë”, në zonat urbane të fshatit, bazuar në aktet e lëshuara nga organet e pushtetit vendor bazuar në VKM 432, datë 14.08.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, të shfuqizuar” dhe me udhëzimet Nr. 2, datë 8.4.2009 dhe Nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pika 2.1 (Trajtuar më hollësisht në faqet 28-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për 273 pasuri gjithsej, prej të cilave 65679 m² “Truall” dhe 15797 m² “Ndërtesë” dhe konkretisht: ZK Kolonjë: 49 pasuri, sipërfaqe “Truall” 9850 m², “Ndërtesë” 1447 m²; ZK Kolonjë qendër urbane: 47 pasuri, “Truall”: 11760 m², “Ndërtesë”: 3337 m²; ZK Kamçisht: 42 pasuri, “Truall” 7869 m², “Ndërtesë” 3376 m²; ZK Imshte: 76 persona, “Truall” 24800 m², “Ndërtesë” 4265 m²; ZK Lifaj i Ri: 15 persona, “Truall” 3000 m², “Ndërtesë” 1139 m²; ZK

Zhelizhan:15 persona, "Truall" 8400 m², "Ndërtesë" 2233 m², deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko- ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua, se në 4 zona kadastrale: Lifaj i Ri, Zhelizhan, Imshte, Kamçisht, janë kryer regjistrime të 116 pasurive tokë "Arë", për sipërfaqen e përgjithshme prej 809323 m² dhe janë lëshuar certifikata pronësie për këto pasuri, origjina e të cilave rrjedh nga Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi, ku nga testimi analitik i AMTP-ve të cilat na u paraqitën nga Sektori i Arkivit ZVRPP Lushnjë, u konstatua se këto AMTP nuk disponoheshin në Arkiv, ose ishin fotokopje të pa njësuara nga pushteti vendor. Përveç kësaj noterizimet nga noterët në një pjesë të madhe janë kryer në mungesë të vulës së thatë dhe të mos nënshkruar nga pala e interesuar.

Konkretisht u konstatuan regjistrime pasuri, tokë "Arë", në mungesë të AMTP-ve, ose noterizimit të jashtëligjshëm të tyre, për zonat kadastrale: ZK Lifaj i Ri: 18 pasuri me sipërfaqe 154247 m²; ZK Zhelizhan: 14 pasuri me sipërfaqe 55628 m²; ZK Imshte: 14 pasuri me sipërfaqe 121050 m²; ZK Kamçisht: 73 pasuri me sipërfaqe 564550 m²;

Në këto pasuri nga Regjistruesi dhe specialisti përkatës është kryer regjistrimi fillestar i këtyre pasurive dhe janë lëshuar "Certifikata për vërtetim pronësie", **në kushtet e mungesës së dokumentit bazë të origjinës (AMTP)**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar, Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", Kreu IV, pika 1, ligjin 7829, datë 01.06.1994, "Për Noterinë", i ndryshuar, nenet 56, neni 67, shkronja "e" dhe me udhëzimet Nr. 2, datë 8.4.2009 dhe Nr. 2, datë 13.06.2013 "Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)", pika 2.1, (Trajtuar më hollësisht në faqet 28-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për 119 pasuri tokë "Arë", për sipërfaqen e përgjithshme prej 895475 m², konkretisht për zonat kadastrale: ZK Lifaj i Ri: 18 pasuri me sipërfaqe 154247 m²; ZK Zhelizhan: 14 pasuri me sipërfaqe 55628 m²; ZK Imshte: 14 pasuri me sipërfaqe 121050 m²; ZK Kamçisht: 73 pasuri me sipërfaqe 564550 m², deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko- ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi volumet e 6 zonave kadastrale Grabjan, Dushk i Madh, Kolonjë, Savër, Kamçisht, Lifaj i Ri, për bilancin e fondit të tokës "Arë", u konstatua si shkelje, se për 14 subjekte të cilët kishin përfituar tokë "Arë", regjistrimet në KPP dhe lëshimi i certifikatave të pronësisë, ishin kryer bazuar në LN-të të cilat rezultojnë në një sipërfaqe më të madhe krahasuar kjo sipërfaqe me sipërfaqen sipas AMTP-ve përkatëse për çdo pronar, e konstatuar kjo, në **14 subjekte** për diferencën e përgjithshme prej **13746 m²** dhe konkretisht Grabjan: 2 subjekte, 1786 m²; Dushk i Madh: 2 subjekte, 1609 m²; Karavasta e Re: 3 subjekte, 582 m²; Kolonjë : 2 subjekte, 5405 m²; Savër: 1 subjekt, 1650 m²; Kamçisht: 1 subjekt, 368 m²; Lifaj i Ri: 3 subjekte, 2346 m².

Sa më sipër, ZVRPP Lushnjë nuk ka vepruar për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin e sipërfaqes tepër në pronësi, Seksioni C "Shtet" **për 13746 m²**, mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", të ndryshuar dhe me udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.06.2013 "Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin

e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)”, pika 2.2 dhe me udhëzimet Nr. 2, datë 8.4.2009 dhe Nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pika 2.1, Gjithashtu janë regjistruar veprime të kryera në vitet 2014-2015, fakte këto që shërbyen si indicie për shtrirjen e auditimit në disa KPP dhe për vitet para vitit 2014 në përputhje me programin e auditimit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në zotërim të 14 subjekteve për diferencën e përgjithshme prej **13746 m²** dhe konkretisht Grabjan: 2 subjekte, 1786 m²; Dushk i Madh: 2 subjekte, 1609 m²; Karavasta e Re: 3 subjekte, 582 m²; Kolonjë : 2 subjekte, 5405 m²; Savër: 1 subjekt, 1650 m²; Kamçisht: 1 subjekt, 368 m²; Lifaj i Ri: 3 subjekte, 2346 m², deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko- ligjor.

Brenda muajit Mars 2017

38. Gjetje nga auditimi: U auditua mbi regjistrimet e kryera në 12 volumet e zonës kadastrale nr. 1827, Grabian, lidhur me shmangiet dhe diferencat e konstatuara ndërmjet sipërfaqeve që rezultojnë dhe janë të pasqyruara në AMTP dhe sipërfaqeve të konstatuara dhe të rezultuara nga LN, printimi III dhe konstatohet si mangësi fakti se në **33 pasuri** një sipërfaqe **38856 m²**, për të 4 volumet 5, 6, 7, 8, regjistrimet janë kryer sipas LN-ve në sipërfaqe më të madhe se sa paraqiten në AMTP, për parcela te veçanta dhe jo për çdo AMTP, prej ku konstatohen diferenca, të cilat duhej të regjistroheshin pronë “Shtet”, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “ Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe me udhëzimet Nr. 2, datë 8.4.2009 dhe Nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pika 2.1 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që në bazë të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe VKM Nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, bazuar në mangësitë e konstatuara, të bëjë bilancin e fondit të tokës për 33 pasuritë me sipërfaqe 38856 m², duke llogaritur për AMTP-të korresponduese edhe pasuritë e tjera të përfituara nga 33 subjektet pronare dhe të nxirren konkluzionet lidhur me sipërfaqet tokë “Arë” të përfituara nga çdo subjekt dhe të regjistruar në KPP, në raport me AMTP-të përkatëse.

Brenda muajit Mars 2017

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi volumet e 2 zonave kadastrale Grabian dhe Kolonjë, konstatohet si mangësi procedurale, se në 26 pasuri për sipërfaqen e përgjithshme 317844 m², sipërfaqet sipas LN-ve janë më të vogla se ato të rezultuara nga dokumenti AMTP ose saktësimeve të kryera dhe janë dhënë certifikata pronësie e janë kryer regjistrime sipas këtyre saktësimeve ose AMTP-ve, sipërfaqe të cilat janë më të mëdha se sa LN printimi III. Në këto pasuri ZVRPP Lushnjë nuk kishte vendosur kufizim pasurie në seksionin “E”, për sipërfaqet e regjistruara sipas faktit dhe nuk janë vënë shënimet në rubrikat “Përshkrimi” dhe “Përshkrim i veçantë” “Diferenca e sipërfaqes Dokument-Fakt”, mosveprim ky në kundërshtim me pikën B. 1.3.4, të udhëzimit të ZQRPP nr. 77, datë 08.05.2003 “Udhëzues për regjistrimin fillestar në zonat urbane” dhe me udhëzimet Nr. 2, datë 8.4.2009 dhe Nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të

administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pika 2.1.

Konkretisht u konstatuan mangësi në zonat kadastrale: Grabian: 21 pasuri, sipërfaqe 306044 m²; Kolonjë: 5 pasuri, 11800 m² (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në tabelën bashkëlidhur Raportit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në mangësitë procedurale të konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për 26 pasuri në sipërfaqen e përgjithshme 317844 m², në 2 zonat kadastrale Grabian dhe Kolonjë, në seksionin “E”, për sipërfaqet e regjistruara sipas faktit, duke vënë shënimet në rubrikat “Përshkrimi” dhe “Përshkrim i veçantë”: “Diferenca e sipërfaqes Dokument-Fakt”, sipas pikës B. 1.3.4, të udhëzimit të ZQRPP nr. 77, datë 08.05.2003 “Udhëzues për regjistrimin fillestar në zonat urbane”, konkretisht në zonat kadastrale: Grabian: 21 pasuri, sipërfaqe 306044 m², Kolonjë: 5 pasuri, 11800 m².

Brenda muajit Mars 2017

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Arkivin e ZVRPP-së Lushnjë, në zonat kadastrale nr. 2207 “Kolonjë” dhe 1582 “Dushk i Madh”, mungonin 23 referenca nga 113 të kërkuara nga grupi i auditimit, ose u plotësuan 20 % të kërkesave.

Nga dokumentacioni në Arkiv, u konstatua se nga Përgjegjësi i Arkivit ishte bërë përpjekje për të marrë në dorëzim dokumentacionin sipas ligjit dhe kjo vërtetohet nga një procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit sipas referencave, por ky proces-verbal nuk ishte pranuar të nënshkruhej nga dorëzuesi (ish-Përgjegjësi i Arkivit).

Në kushtet e mësipërme rezulton se Arkiva është e pa inventarizuar së paku prej 3 vjetësh, veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.1.2003, “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 149-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që në bazë të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe ligjit nr. 9154, datë 6.1.2003, “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”, të plotësojë inventarin arkivor të ZVRPP-së me 23 referencat të cilat mungonin, duke ngritur grup pune për këtë qëllim dhe duke kryer ballafaqimet e nevojshme me të gjithë personat përgjegjës për këtë inventar.

Brenda muajit Mars 2017

41. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, u konstatua se në zonën kadastrale Karavasta e Re, ishin kryer regjistrime të objekteve të përfituara nga ligji Nr. 7512, datë 10.08.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, konkretisht për pasurinë 135/10, “Ndërtesë (Kompleks Blegtoral)” me sipërfaqe 36132 m², regjistrim i kryer në mungesë të kontratës së marrëdhënies me truallin (kontrata e qirasë) dhe për mos likuidimin e vlerës së plotë të objektit, mosveprime këto në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 7.2. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 135/10, “Ndërtesë (Kompleks Blegtoral)” me sipërfaqe 36132 m², regjistruar në KPP v. 8, f. 143 më datë 19.03.2014, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko- ligjor të kontratës së marrëdhënies me truallin dhe likuidimin e vlerës së plotë të objektit.

Brenda muajit Mars 2017

42. Gjetje: Në 1 rast në KLSH me prot. nr. 945, datë 22.09.2016 është regjistruar ankesa nga qytetari A. L, në lidhje me mos regjistrimin nga ZVRPP Lushnjë të vendimit të KK Pronave ish-pronarëve nr. 13, datë 11.12.1994, në ZK 8572 dhe kundërshtimin e regjistrimit të vendimi nr. 103, datë 29.09.1994, për regjistrimin e titullit të pronësisë të trashëgimtarëve të familjes P sipas referencë nr. 05184, ku pretendohet se regjistrimi i origjinës së truallit është bërë në bazë të vendimit të gjykatës nr. 578, datë 12.01.1998, që ka për objekt pjesëtimin e pasurisë truall me sipërfaqe 800 m², pa patur të regjistruar më parë këtë pronë, ndërsa gjykata ka vendosur miratimin e pajtimit të arritur midis palëve ndërgjyqës, paditësit K. P. dhe të paditurit H. P. të cilët marrin secili ½ pjesë me 335 m², ndërkohë që nga dëshmia e trashëgimisë nr. 177, datë 17.08.1993 rezulton të jenë 5 trashëgimtarë. Pra në dosje, nuk administrohet dorëheqje nga pronësia apo akt dhurimi nga pjesëtarët e tjerë.

Ky vendim gjykate ka pjesëtuar send, pa e pasur të regjistruar atë më parë në ZVRPP Lushnjë.

Gjithashtu nuk ndodhet në arkiv referenca që i përket privatizimit të objektit kinema verore, praktikë kjo për të cilën është lëshuar vërtetimi hipotekor nr. 47, datë 04.07.1994 me përmbajtje që në emër të K, H, P, M. dhe Xh. P. figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor objekti “kinema verore”, me sipërfaqe 368 m².

Duke shqyrtuar vendim nr. 103, datë 29.09.1994, konstatohet se është i falsifikuar, pasi fleta e dytë nuk përmban nënshkrimin e anëtarëve të komisionit, siç përmbajnë fleta e parë dhe e tretë dhe se ka shkrim të ndryshëm nga dy fletët e tjera. Në lidhje me këtë konstatim nëpërmjet ZVRPP Lushnjë me shkresë nr. 8464, datë 05.10.2016, ju kërkua ATP Tiranë konfirmimi i vendimit për vërtetësinë e tij.

Gjatë periudhës së auditimit në lidhje me vendimet e komisionit të KKK Pronave ish-pronarëve nr. 13, datë 11.12.1994 të familjes L dhe nr. 103, datë 29.09.1994 të familjes P, u krijuar grupi i punës me i përbërë nga z. E. P., me detyrë zv-regjistruar, z. Sh. M. dhe z. A.J. me detyrë hartografë për hedhjen në hartën e punës të dy vendimeve si dhe verifikimin në vend të dy këtyre pronave dhe ka rezultuar që **sipërfaqja prej 30 m²** nga pjesa që i përket vendimit nr. 13, datë 11.12.1994 posedohet nga ana e H. P., **pra krijohet mbivendosje**, pasi kjo sipërfaqe është brenda sipërfaqes së njohur dhe kthyer sipas vendimit të sipërcituar nr. 13, datë 11.12.1994 të familjes L.

Në lidhje me kontradiktat e krijuara për pronësinë nga ankuesi dhe trashëgimtarët e O., L. dhe Q. L. kanë paditur Agjencinë Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Bashkinë Lushnjë, Shoqërinë “I” ShPK, K.P., H. P. dhe Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 103, datë 29.09.1994 të KKK Pronave të Bashkisë Lushnjë, dalë në bazë të vendimit nr. 1196, datë 14.03.1993, vendim fakti, ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 13, datë 11.12.1994, të KKK Pronave të Bashkisë Lushnjë, shfuqizimin e sheshit të ndërtimit nr. 25, datë 05.12.2006 dhe lejes së ndërtimit nr. 26, datë 16.01.2007, për shkak të shfrytëzimit me pa të drejtë të pronës së tjetrit dhe të mos zbatimit të kondicioneve të urbanistikës duke bërë të mundur cenimin e pronësisë së tjetrit dhe detyrimin e ZVRPP Lushnjë për fshirjen e hipotekës në emër të paditurve K.P. e H.P. dhe shoqërisë “I” ShPK.

Në përfundim kërkesa e z. A. L. është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Lushnjë sipas **vendimit nr. 393, datë 02.04.2012 dhe në pjesën vendimore shpreh:**

Rrëzimin e kërkesë padisë, të paraqitur nga paditësit: O.L., L. L., Q.L. kundër të paditurve: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë; Bashkia Lushnjë; Shoqëria “I” ShPK; K. P.; H.P.; Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë me objekt:

- kundërshtimin e vendimit nr. 103, datë 29.09.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Lushnjë, dalë në bazë të vendimit nr. 1196, datë 14.03.1993 vendim fakti.

- ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 13, datë 11.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Lushnjë.

- shfuqizimin e sheshit të ndërtimit nr. 25, datë 05.12.2006 dhe lejes së ndërtimit nr. 26, datë 16.01.2007, për shkak të shfrytëzimit me pa të drejtë të pronës së tjetrit dhe të mos zbatimit të kondicioneve të urbanistikës duke bërë të mundur cenimin e pronësisë së tjetrit.

- detyrimin e Zyrës së Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për fshirjen e hipotekës në emër të paditurve K. P. H. P. dhe shoqërisë "I".

Kundër këtij vendimi është bërë ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe me vendimin nr. 149, datë 27.02.2013 është lënë në fuqi vendimi i gjykatës nr. 393, datë 02.04.2012.

Në përfundim nga ana e gjykatave është marrë vendim i formës së prerë në lidhje me ankesën e z. A. L., duke lënë në fuqi titullin e pronësisë të familjes P.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në rastet e trajtimit të çështjeve me vendime gjyqësore nuk ka tagrin ligjor dhe nuk mund të vijojë me trajtimin dhe shqyrtimin e ankesës, pasi titulli i pronësisë është zgjidhur me vendimet gjyqësore të sipërcituara duke marrë formë të prerë pa u ankimuar në gjykatën e shkallës më të Lartë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 142-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", të beje identifikimin dhe evidentimin e pasurive të regjistruara me mbivendosje dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore në zbatim të përcaktimeve të pikës 3, neni 37, neni 59 dhe pika 1 e nenit 60 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", si dhe të bëjë njoftimin e palëve, për ndjekjen e procedurave ligjore për zgjidhjen e mbivendosjes lidhur me pasuritë rezultuar me mbivendosje përkatësisht për sipërfaqen prej 30 m², pjesë e pasurisë nr. 8/147.

- Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit t'i kthehet përgjigje ankuesit se kërkesa e tij është gjykuar me vendim gjykate të shkallës së parë dhe Apelit dhe nuk është bërë ankimim në shkallë më të lartë gjykimi.

Brenda muajit Mars 2017

43. Gjetje: Nga punonjësit ZVRPP Lushnjë, në të gjitha rastet e audituara nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të Vendimeve të gjykatës, Aktit Noterial dhe Aktit Administrativ, si dhe nuk është plotësuar *shtojca 1, 2, 3*, veprim në papajtueshmëri me nenin 42, dhe pikën 5 neni 45, të Ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit" (*Trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që për çdo rast të verifikohen e elementët e formës dhe të përmbajtjes, duke plotësuar *shtojcat 1, 2, 3*.

Në vijimësi

44. Gjetje: Nga hartografi i ZVRPP Lushnjë, nuk është përgatitur plan rilevimi për çdo pasuri që është regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme ku të përcaktoj me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë, veprim në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që për çdo rast të përgatitur plan rilevimi nga hartografi i ZVRPP duke e krahasuar me plan rilevimin e ardhur nga topografi me licencës.

Në vijimësi

45. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në të gjitha rastet e audituara, dokumentacioni që ndodhet në dosje është i pa inventarizuar për çdo fletë, fleta e inventarit nuk është plotësuar më të gjitha të dhënat, veprim në papajtueshmëri me kreun V, të ligjit nr. 9415, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, pikën 2.6, të kreut III, të Rregullores nr. 2079, datë 11.06.2007 “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe pikën 4 të Urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 1436, datë 2.11.2010 “Për procedurën e mbajtjes së azhurnuar në mënyrë digjitale të dokumentacionit të zonave kadastrale që kalojnë në regjistrim fillestar” (*Trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, të fillojë inventarizimin e të gjitha referencave që ndodhen në arkiv të pa inventarizuara duke përcaktuar dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim.

Në vijimësi

C. MASE PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi rezultuan *shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerë 82,986,345 lekë*, që përbëhet nga mosarkëtimi i të ardhurave nga tarifa e regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, nga mos llogaritje e tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit (diferencës preventiv-situacion), për mosllogaritje tarife të taksës së kalimit të pronësisë për sipërfaqet e përbashkëta, gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit, nga mos aplikimi i gjobave për vonesa në regjistrim të akteve noteriale, nga mosllogaritja e tarifës qirasë për trojet që rrjedhin nga procesi i privatizimit të objekteve shtetërore dhe nga mos llogaritje qiraje të papaguar nga subjekti “Kompleksi blegtoral”, sipas 5 rekomandimeve të lëna dhe konkretisht:

1. Gjetje: ZVRPP Lushnjë për **12 raste**, të marrë masat për arkëtimin e *vlerën 6,608,215 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit*, që vijnë nga mosarkëtimi i të ardhurave nga tarifa e regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, nga mos llogaritja e tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit (diferencës preventiv-situacion), për mosllogaritje të tarifës së taksës së kalimit të pronësisë për sipërfaqet e përbashkëta gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit dhe nga mos aplikimi i gjobave për vonesa në regjistrim të akteve noteriale, e përbërë nga:

- vlera **prej 1,515,576 lekë lekë** ndaj subjektit “A” shpk, sipas referencë nr. 09222, për pasuria nr. 1/229, regjistruar volum 23, faqe 69, e përbërë nga: sipërfaqe të përbashkëta të pa regjistruara 1693.68 m² x 700 lekë m² sipas tarifës = 1,185,576 lekë; diferenca prej 1500 lekë për njësi 77 njësi (nga 6500 lekë prerë 5000 lekë) = 115,500 lekë; pa prerë aplikime për 33 njësi të individualizuara garazhe x 6500 lekë secili = 214,500 lekë, pasi kati bodrum është regjistruar si njësi të vetme me sipërfaqe 1174 m², ndërkohë që sipas planimetrisë rezulton se ka gjithësej 33 njësi të ndara e të individualizuara garazhe.

- vlera **prej 1,312,011 lekë lekë** ndaj subjektit “T.” ShPK, sipas referencë nr. 008799, për pasurinë nr. 1/462 volum 22, faqe 189 e përbërë: sipërfaqe të përbashkëta të pa regjistruara 1160.73 m² x 700 lekë m² sipas tarifës = 812,511 lekë; diferenca prej 3500 lekë për njësi 87 njësi (nga 6500 lekë prerë 3000 lekë) = 304,500 lekë dhe pa prerë aplikime për 30 njësi të individualizuara garazhe x 6500 lekë secili = 195,000 lekë;

- vlera **prej 240,100 lekë lekë** ndaj subjektit “G” ShPK, sipas referencë nr. 08213, për pasuria nr. 1/437, regjistruar në volum 20, faqe 168, e përbërë sipërfaqja e përbashkët e pa regjistruar 343 x 700 lekë.

- vlera **prej 1,047,187 lekë lekë** ndaj subjektit “G” shpk, sipas referencë nr. 011536, për pasuria nr. 1/540, regjistruar në volum 24, faqe 156, e përbërë sipërfaqja e përbashkët e pa regjistruar 457.33 x 700 lekë dhe diferenca midis situacionit përfundimtar dhe preventivit

është 24.235.214 lekë e barabartë me 727,056 lekë të ardhura të munguara për bashkinë Lushnjë,

- vlera **prej 182,581 lekë lekë** ndaj subjektit “I.” ShPK, sipas referencë nr. 011611, për pasuria nr. 8/147, regjistruar në volum 24, faqe 229, e përbërë sipërfaqe e përbashkët 260.83 x 700 lekë.

- vlera **prej 781,760 lekë lekë** ndaj subjektit “E. dhe A.”, sipas referencë nr. 08232, pasuria nr. 9/239, e përbërë sipërfaqe e përbashkët 1116.8 m² x 700 lekë.

- vlera **prej 210,000 lekë** sipas referencë nr. 0012216, për pasurinë nr. 12/9+1-23, të llojit apartament me sipërfaqe 74 m², është vendosur masë sekuestro me Urdhër regjistruesi nr. 50, date 29.01.2014, por nuk janë llogaritur vonesa në regjistrim të dëshmisë së trashëgimisë.

- vlera **prej 210,000 lekë** sipas referencë nr. 0012174, pasuria nr. 11/135, volum 25, faqe 173, truall + ndërtesë me sipërfaqe 200 m² nga kjo 70.3 m² banese, ku llogariten 600 ditë vonesa.

- vlera **prej 300,000 lekë** sipas referencë nr. 0012201, pjesëtim pasurie nr. 9/76 të llojit truall me sipërfaqe 170 m², volum 19, faqe 61, me Vendim Gjykate, ditë-vonesat vendimi ka marrë formë të prerë me 18.11.2010 dhe është aplikuar ne 25.03.2014.

- vlera **prej 300,000 lekë** sipas referencë nr. 0012309, për pasuritë nr. 1/265, të llojit truall me sipërfaqe 150 m² dhe nr. 1/250, të llojit truall me sipërfaqe 224 m², për kthim sendi me vendim gjykate, pa llogaritet ditë vonesa në regjistrim.

- vlera **prej 210,000 lekë** sipas referencë nr. 0013055, për regjistrim pronësie me vonesa në regjistrim sipas kontrate privatizimi apartamenti me sipërfaqe 71.3 m², pasuria nr. 5/12+1-20, ne v. 25, faqe 244.

- vlera **prej 300,000 lekë** sipas referencë nr. 0013077, për regjistrim dëshmi trashëgimie me vendim gjykate viti 2011, ndërsa aplikuar në vitin 2015, për pasurinë nr. 6/143, të llojit apartament me sipërfaqe 75 m². Nuk janë paguar penalitete për vonesa në regjistrim, veprime në papajtueshmëri me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” (Trajtuar në faqet 57-69 dhe 113-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë, të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **6,608,215 lekë** për pasuritë trajtuara rast pas rasti, deri në arkëtimin e plotë të vlerës.

Brenda muajit Mars 2017

2. Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit për 11 subjekte u konstatua një **dëm ekonomik në vlerën 14,615,330 lekë që është si rezultat** i mos llogaritjes së tarifës së taksës ndikimit në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit(diferencës preventiv-situacion), për mosllogaritje tarifës taksës së kalimit të pronësisë për sipërfaqet e përbashkëta, gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit, nga mos llogaritja e tarifës qirasë për trojet që rrjedhin nga procesi i privatizimit të objekteve shtetërore të evidentuara si detyrim në kontrata e shitjes së objekteve për lidhjen e kontratës me seksionin e financës së Këshillit Rrethit dhe mos vlerësim i truallit regjistruar me legalizim pa dokumentacion përkatës në origjinë për periudhën 01.01.2014-30.06.2016 (Trajtuar më hollësisht në faqet 70-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: ZVRPP Lushnje Regjistruesi të marrë masa për kufizimin e pasurive deri në arkëtimin e detyrimit nga 12 subjektet evidentuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi si më poshtë:

Nr	Subjekti	Ref.	Taksa ndikimit infrast. 3%	Sipëf.Përb	Vlera lekë
1	“G” ShPK	08467	58,155	403,375	461,530
2	“A” ShPK	08665	-	795,305	795,305
3	“B” ShPK	09316	809,650	142,800	952,450

4	F.T	09424	601,152	414,134	1,015,286
5	Xh.	09435	-	35,262	35,262
6	A.	09927	4,781,574	607,509	5,389,083
7	“T” ShPK	09831	637,245	2,713,000	3,350,245
8	A.	10104	-	50,400	50,400
9	E.	10118	-	54,600	54,600
10	R.	10937	133,929	287,000	420,929
11	A.	1171	Detyrim Qiraje nga kontr.Priv.	-	2,190,240
	TOTALI				14,615,330

Brenda muajit Mars 2017

3. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 630/108-N1, ndërtesë me sipërfaqe 72 m², volum 53, faqe 138, pasi përveç tarifës së regjistrimit, *për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, nuk ka aplikuar kamatëvonesë, në shumën 300,000 lekë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit*, veprim në papajtueshmëri me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 91-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **300,000 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

4. Gjetje: ZVRPP Lushnjë në **1 rast**, ka regjistruar e lëshuar certifikatë për pasurinë nr. 449/14, Pus Naftë me sipërfaqe 850 m², volum 2, faqe 138, pasi përveç tarifës së regjistrimit, *për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, nuk ka aplikuar kamatëvonesë, në shumën 300,000 lekë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit*, veprim në papajtueshmëri me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 91-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **300,000 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, u konstatua se në zonën kadastrale, Karavasta e Re, ishin kryer regjistrime të objekteve të përfituara nga ligji Nr. 7512, datë 10.08.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, konkretisht për pasurinë 135/10, “Ndërtesë (Kompleks Blegtoral)” me sipërfaqe 36132 m², regjistrim i kryer në mungesë të kontratës së marrëdhënies me truallin (kontrata e qirasë) dhe për mos likuidimin e vlerës së plotë të objektit, mosveprime këto në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 7.2.

Duke llogaritur qiranë e papaguar nga subjekti *vetëm për periudhën nën auditim 01.01.2014 deri më 30.06.2016*, (pra 30 muaj), sipas VKM nr. 529, datë 08.06.2011, “Për përcaktimin e kriteve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të

pasurisë shtetërore” si dhe vlerën e pa likuiduar të objektit, **konstatohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 61,162,800** (46,262,800 lekë qira e papaguar+15,360,000 lekë diferencë vlere e objektit), të ardhura të llogaritura të cilat do të realizoheshin nëse do të ishte lidhur dhe zbatuar kontrata e qirasë mbi truallin pronë “Shtet”, vetëm për periudhën 01.01.2014 deri më 30.06.2016 (Trajtuar më hollësisht në faqet 99-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Lushnjë të marrë masa, **bazuar në shkeljet e konstatuara** për pasurinë nr. 135/10, “Ndërtesë (Kompleks Blegtoral)” me sipërfaqe 36132 m², regjistruar në KPP v. 8, f. 143 më datë 19.03.2014 dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, deri në arkëtimin e **shumës 61,162,800 lekë** (46,262,800 lekë qira e papaguar+15,360,000 lekë diferencë vlere e objektit) prej subjekteve pronarë të objektit, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse të cilat kanë truallin në pronësi, nëpërmjet rrugës zyrtare.

Deri më datë 31.03.2017

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **të kërkojmë Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga puna”** dhe për ata me kontratë, nga masa **“Vërejtje”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, për këta punonjës:

1. Për z. A.D., me detyrë **Regjistruesi** prej 30.07.2015 e vazhdim, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 16, datë 13.10.2016, nr. 18, datë 13.10.2016, nr. 22, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

4. Për z. Sh.M., me detyrë **specialist** prej 11.12.2013, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 12, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

5. Për z. A.J., me detyrë **specialist** prej 01.02.2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 25, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

6. Për znj. E.Ll., me detyrë **specialiste** prej 04.03.2013, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016, nr. 29, datë 14.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

7. Për znj. A.Sh., me detyrë **specialiste** prej 25.11.2013, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 16, datë 13.10.2016, nr. 18, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

8. Për z. J. B., me detyrë **specialist** prej 21.01.2010, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 18, datë 13.10.2016 dhe nr. 25, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

9. Për z. J.Sh., me detyrë **specialist** prej 01.11.2013, për shkeljet trajtuar në procesverbalin nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 40, datë 14.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

10. Për z. D.K., me detyrë **specialist** në detyrë, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

11. Për z. E.S., me detyrë **specialist** prej 06.03.2014, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 16, datë 13.10.2016, nr. 19, datë 13.10.2016, nr. 18, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016, nr. 27, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

12. Për z. A.K., me detyrë **specialist** në detyrë, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

13. Për z. I.B., me detyrë **specialist** në detyrë, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

C. 2. “Zgjidhje të kontratës individuale të punës”, për:

1. G. D. me detyrë Jurist.

- **Për regjistrimin e pasurisë**, nr. 46/95, volum 6, faqe 130 në mungesë të **AMTP nr. 10068 me sipërfaqe totale 10276 m² arë**, duke ligjëruar në këtë mënyrë kryerjen e veprimeve absolutisht të pa vlefshme, për regjistrimin e pasurisë nr. 109/31, volum 2, faqe 141 sipas **AMTP nr. 8656 i cili është kopje, si dhe për veprimet e kryera pa u bërë saktësimi i sipërfaqeve LN/AMTP**, duke regjistruar më tepër një sipërfaqe prej 546 m². Gjithashtu ZVRPP-ja, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, bashkisë dhe DAMT-it, pranë Këshillit të Qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqesin në ZVRPP, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç” pika 2.2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”. Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

2- B.D. me detyrë specialiste.

- **Për regjistrimin e pasurisë** nr. 144/1, volum 2, faqe 165, përfituar sipas **AMTP nr. 9819 i cili është kopje pa njëjësuar me origjinalin, duke ligjëruar në këtë mënyrë kryerjen e veprimeve të mëtejshme për regjistrimin e një sipërfaqe prej totale 12434 m² e cila rrjedh nga një akt absolutisht i pa vlefshëm**, gjithashtu ZVRPP-ja, nuk i është drejtuar mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, bashkisë dhe DAMT-it, pranë Këshillit të Qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqesin në ZVRPP, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “b” pika 4, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”. Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 26-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- **Për regjistrimin e pasurisë** nr. 449/14, Pus Naftë me sipërfaqe 850 m², volum 2, faqe 138, në kushtet kur: Akti i cili ka sjell ndryshim dhe ose përfitim të drejtave të pronësisë “Urdhri i Ministrit të Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit nr. 614, prot datë 28.12.2001” është kopje, i cili nuk përmban të dhënat për vlerën, kufijtë, sipërfaqen dhe vendndodhjen e pasurisë së paluajtshme. Urdhri nr. 614, prot datë 28.12.2001 është lëshuar përpara VKM nr. 219 datë 16.04.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrim “A. sh.a”. Gjithashtu ky vendim nuk ka bashkëlidhur listën e pronave e cila përbëhet nga 180 fletë. Në dosje mungon: Plan rilevimi, planimetria e objekteve (struktura e pusit), veprime këto në papajtueshmëri me pikën a neni 25, pika 2 neni 45 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 dhe 3 të VKM nr. 553, Date 28.8.1998 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Shoqërive Tregtare, të Krijuara nga Transformimi i Ndërmarrjeve Shtetërore” (*trajtuar në faqen 162-163 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*).

3- I. B. me detyrë specialist.

- Për regjistrimin e pasurisë, nr. 147/11, volum 3, faqe 73, pasi *AMTP nr. 9735* administrohet në ZVRPP Lushnjë kopje e pa njësuar plotësisht me origjinalin, pasi nuk ka datën dhe vitin e njësimit, mungon vula e thatë, nënshkrimi i noterit, noteri nuk përcakton kush e ka paraqitur dokumentin për njëjësimit, duke ligjëruar në këtë mënyrë regjistrimin e një sipërfaqe prej 28000 m² arë e cila rrjedh nga një akt në kushtet e pavlefshmërisë absolute, *gjithashtu ZVRPP-ja, nuk ka kryer verifikimet nëse pasuritë pjesë përbërëse të këtij akti krijojnë mbivendosje me pasuri tjetër*, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me nenin 56, shkronjën “e” neni 67 Ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar shkronjën “ç” pika 2.2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”. Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në procesverbalet dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

I. Për **5** ish drejtuesit dhe **8** ish punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte: **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, përkatësisht për:

1. Për z. A.H., me detyrë **ish-Regjistrues** prej vitit 1996 deri 2006, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 14, datë 13.10.2016, nr. 17, datë 13.10.2016, nr. 19, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016, nr. 24, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Për z. F.H., me detyrë **ish-Regjistrues** prej vitit 2006 deri 2008, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 14, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 17, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016, nr. 24, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Për z. S.K., me detyrë **ish-Regjistrues** prej vitit 2010 deri 2013, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 13, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

4. Për z. B.K., me detyrë **ish-Regjistrues** prej vitit 2013 deri 2014, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, datë 10.10.2016, nr. 3, datë 12.10.2016, nr. 28, datë 14.10.2016, nr. 40, datë 14.10.2016, nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 13, datë 13.10.2016, nr. 16, datë 13.10.2016, nr. 18, datë 13.10.2016, nr. 19, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016, nr. 21, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016, nr. 26, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

5. Për z. E.B., me detyrë **ish-Regjistrues** për vitet 2014 deri 2015, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 18, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016, nr. 26, datë 13.10.2016, nr. 27, datë 13.10.2016, nr. 29, datë 14.10.2016 në faqet përkatëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6. Për znj. M.M., me detyrë **ish-specialiste**, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 14, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr.

17, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016, nr. 24, datë 13.10.2016, nr. 25, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

7. Për z. S.K., me detyrë **ish-specialist** prej 25.11.2013 deri 27.04.2016, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 1, datë 10.10.2016, nr. 3, datë 12.10.2016, nr. 29, datë 14.10.2016, nr. 40, datë 14.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 19, datë 13.10.2016, nr. 26, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

8. Për znj. Xh.S., me detyrë **ish- specialiste**, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 11, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 23, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

9. Për znj. S.Xh., me detyrë **ish-specialiste**, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 20, datë 13.10.2016 dhe nr. 21, datë 13.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

10. Për z. D.L., me detyrë **ish- specialist** prej 11.12.2013, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 8, datë 13.10.2016, nr. 12, datë 13.10.2016, nr. 15, datë 13.10.2016, nr. 19, datë 13.10.2016, nr. 20, datë 13.10.2016, nr. 26, datë 13.10.2016, nr. 29, datë 14.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

11. Për z. A. Ll., me detyrë **ish-hartograf**, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 2, datë 10.10.2016, nr. 28, datë 14.10.2016 dhe nr. 40, datë 14.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

12. Për z. E. L., me detyrë **ish-jurist**, për shkeljet trajtuar në procesverbalet nr. 28, datë 14.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

13. Për z. A. R., me detyrë **ish-specialist** deri në vitin 2013, për mangësitë trajtuar në procesverbalin nr. 2, datë 11.10.2016, nr. 28, datë 14.10.2016 dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit.

D. KALLZIM PENAL

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, sugjerohet trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Standardeve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

1. B. K. me detyrë ish-regjistruer;
2. S. K. me detyrë ish-jurist;
3. E. B. me detyrë ish-regjistruer;
4. S. K. me detyrë ish-regjistruer, larguar nga detyra në muajin shtator 2013;
5. D. Ll. me detyrë Jurist;
6. G. D. me detyrë jurist;
7. A. H. me detyrë ish/ Regjistruer larguar nga detyra në muajin shkurt 2006;

- Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Gjithashtu gjatë auditimit janë gjetur mangësi dhe shkelje ligjore nga z A. Ll., me detyrë ish hartograf, znj. B.D., me detyrë juriste, znj. S.Xh. me detyrë ish juriste dhe M. M. me detyrë specialiste, për të cilët nuk kemi sugjeruar kallëzim penal, pasi shkeljet janë gjetur në një rast të vetëm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe

Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtori i Derpartamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R